



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS 07. 02. 2017

01. nr. 346/-0027034/më /19

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/04, qershor 2008), të Rregullores për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, 01. nr. 344 - 3707, të datë 31.01.2012, dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më \_\_\_\_\_, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, lidhur me vendimin për zgjatjen e afatit kohor të licencave për automjetet e transportit taksi.
- II. Operatori që posedon automjet të tipit EURO IV e sipër, me ngjyrë të bardhë, ju jepet licenca për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve me kohëzgjatje për 5 (pesë) vjet.
- III. Operatorëve të cilët nuk posedojnë automjete si në pikën II të këtij vendimi, do t'u vazhdohet dhënia e licencës me kohëzgjatje për 1 (një) vit.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
- Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti

07. 02. 2017

Shpend Ahmeti